**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **Dogana e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201/13300-26-2827-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me kondicionerë të ri si dhe servisimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve ekzistues**

# ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit*

| | |
|---|---|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | **AS Tech SH.P.K.** |
| NUI | **601262611** |
| Adresa | **Haxhi Kleqka** |
| Vendi | **Lipjan** |
| Kodi postar | **-** |
| Numri Telefonit | |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | **AFRIM SADIKU** |
| Adresa elektronike | **shpk.astech@gmail.com** |
| Data e parashtrimit të ankesës | **20.07.2026** |

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin ıë të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Ankesa i përket grupeve:

**Furnizimi me kondicionerë të ri si dhe servisimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve ekzistues**

**Njoftimi për kontrate publikuar : 30.04.2026**

**Afati i dorëzimit te tenderëve 25.05.2026**

**Data e hapjes se tenderëve 25.05.2026, koha 14:30,**

**Njoftimi mbi vendimin e AK 30.06.2026**

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

E-prokuirmi

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

***Po*** ☒ ***Jo*** ☐

## *6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve*

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

**Ne sistem ndodhen te gjitha**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e*

*Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 6 LPP - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
**Neni 7 LPP - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
**Neni 56 i LPP - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
**Neni 59 i LPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 72 i LPP- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**
**Neni 40 i Rregullores se prokurimit publik - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, ne mbështetje te nenit 108/A te LPP-se paraqesim këtë ankesë kundër vendimit për eliminimin tone nga ky aktivitet dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit në lartcekur, me arsyetimin se:

a) Asnjëri prej tenderëve te pranuara nuk është I përgjegjshëm

Ne referim te vendimit te AK-se lidhur me aktivitetin e lartcekur të prokurimit, ne si operator ekonomik AS Tech SH.P.K., parashtrojmë këtë Ankese, me qëllim të kthimit të procedurës në rivlerësim dhe respektimit të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)

Ne letrën standarde për eliminimin e kompanisë sonë AK e specifikon se:

Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye:

Nuk plotësohen të gjitha kërkesat sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit.Në specifikim është kërkuar klasa e energjisë për ngrohje min A+++ dhe ftohje min A++,ndërsa modeli që ju keni ofertuar ka klasën A++ për ngrohje dhe A+++ për ftohje.

Ne dosjen e tenderit tek kërkesat e specifikimit teknik është kërkuar

| Specifikat teknike/Modeli | Inverter 12000 BTU | Inverter 18000 BTU | Inverter 24000 BTU |
|---|---|---|---|
| Klasa e Energjisë - Ngrohje | Min A+++ | Min A+++ | Min A+++ |
| Klasa e Energjisë - Ftohje | Min A++ | Min A++ | Min ++ |

Ne kemi dorëzuar klima te cilat janë me A+++ si ne ftohje ashtu edhe ne ngrohje por qe nga ana e AK-se nuk janë marr parasysh.

Me eliminimin e ofertës sonë dhe anulimin e këtij aktiviteti AK ka vepruar ne kundërshtim te plote me nenit 6 te LPP-se ku ne piken 1 te këtij neni specifikohet se:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Përveç nenit 6 mendojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim edhe me nenin 7 te LPP-se"

Konsiderojmë se AK gjate vlerësimit te këtij aktiviteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se gjegjësisht nenit 59.4 ku specifikohet se:

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ne konsiderojmë se klimat me te cilat kemi aplikuar janë ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe njeherit janë edhe me ekonomike dhe me kualitative pasi qe janë me A+++ si ne ftohje ashtu edhe ne ngrohje për ta dëshmuar ketë ne po ju bashkëngjisim katalogun për modelet e klimave me te cilat kemi ofertuar ne te cilin specifikohet sakt edhe modeli i klimës siç ne kemi ofertuar

| Items<br>Model | WMSE7 - Hoobart<br>-12000BTU | -18000BTU | -24000BTU |
|---|---|---|---|
| Rated Voltage | 220v-240v | 220v-240v | 220v-240v |
| Rated Frequency | 50Hz | 50Hz | 50Hz |
| Pdesign-cooling (kW) | 3.5 | 5.4 | 6.1 |
| Pdesign-heating (kW)-**average** | 2.8 | 4.4 | 5.4 |
| Annual power consumption-cooling (kwh/a) | 145 | 215 | 246 |
| Annual power consumption-heating (kwh/a) | 853 | 1339 | 1644 |
| GWP | 675 | 675 | 675 |
| Pdesign-heating (kW)-**warmer** | 3.4 | 5.4 | 6.8 |
| Annual power consumption-heating (kwh/a) | 866 | 1303 | 1763 |
| Cooling Capacity (BTU/H) | 11942 | 18424 | 24566 |
| Cooling Capacity (kW) | 3.5(0.65-4.1) | 5.4(1.3-5.9) | 7.2(1.8-7.4) |
| Heating Capacity (BTU/H) | 14330 | 19789 | 24907 |
| Heating Capacity (kW) | 4.2(0.93-4.2) | 5.8(1.3-6.1) | 7.3(1.8-8.0) |
| Cooling Current (A) | 4.2(0.56-5.8) | 6.4(2.2-6.8) | 7.9(1-10) |
| Heating Current (A) | 4.8(1.0-6.3) | 6.1(2.0-8.0) | 10.5(1-11) |
| Cooling Input (kW) | 0.87(0.13-1.55) | 1.43(0.29-1.95) | 1.7(0.23-2.3) |
| Heating Input (kW) | 1.06(0.23-1.30) | 1.33(0.25-1.8) | 2.3(0.23-2.53) |
| Dehumidification capacity (L/h) | 1.7 | 2.5 | 3.1 |
| SEER Cooling | 8.7 | 8.7 | 8.7 |
| SEER energy class | **A+++** | **A+++** | **A+++** |
| SCOP Heating-**average** | 4.7 | 4.6 | 4.6 |
| SCOP energy class-**average** | **A++** | **A++** | **A++** |
| SCOP Heating-**warmer** | 5.5 | 5.8 | 5.4 |
| SCOP energy class-**warmer** | **A+++** | **A+++** | **A+++** |
| Max. Input Current (A) | 9 | 12 | 16 |
| Max. Input Power (kW) | 1.5 | 2.4 | 3.2 |
| Max. Discharge Pressure (Mpa) | 4.3 | 4.3 | 4.3 |
| Max. Suction Pressure (Mpa) | 2.5 | 2.5 | 2.5 |
| Refrigerant | R32 | R32 | R32 |

Nëse AK gjate vlerësimit te këtij aktiviteti ka pasur paqartësi rreth specifikimit teknik te klimave qe ne i kemi ofruar është dashur qe ta zbatoj nenin 72 te LPP-se dhe te kërkoj sqarime rreth kësaj kërkese.

Me mos respektimin e këtij neni konsiderojmë se AK nuk ka bere vlerësim te drejt dhe njeherit ka ardhe ne përfundim te pasaktë rreth përgjegjshmërisë se ofertës sonë pasi qe ne si OE kemi dorëzuar oferte te përgjegjshme administrativisht dhe kemi ofruar pajisje ne përputhje te plote me kërkesat e specifikimit teknik.
Po ashtu vlen te specifikohet se përveç se jemi OE i përgjegjshëm qe i plotësojmë te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate oferta jone edhe oferta me e lire e dorëzuar për ketë aktivitet.

Duhet pasur parasysh se eliminimi i kompanisë sonë dhe anulimi i pa bazuar ne legjegjislacion i këtij aktivitetit është shkelje e procedurave te prokurimit dhe ne kundërshtim te plote me legjislacionin ne fuqi.
Ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim AK nuk ka dhene me shume bindje te menyres s evleresimit te ofertes tone veten ka perseritur detajte e Vendimit te Ak-se.
AK ka bere shkelje duke na eleminuar per nje kriter pa asnje baze ligjore, katallgu shume mire cek qe i plotesojme klasen e ergjise per ngrohje Scoop energy class warmer A+++ dhe per ftohje SEER energy class A+++, dhe nuk kemi njohuri mbi qafre baze eshte elminuar oferta jone.
Andaj konsiderojmë OSHP pas shqyrtimit te kësaj Ankese ne përputhje me legjislacionin në fuqi duhet te nxjerr vendim për anulimin e njoftimit B58 te datës 30.06.2026 dhe kthen lenden ne ribleresimper kete aktivitet te prokurimit pasi qe jemi te vetmit qe i plotësojmë te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne Dosje te tenderit dhe njoftimin për kontrate.
Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke eliminuar padrejtësisht ofertën tonë, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.

**Për këto arsye, duke u mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregulloren përkatëse, kërkojmë nga OSHP që:**
1. **Të anulojë Njoftimin mbi Vendimin e datës 30.06.2026;**
2. **Të kthejë çështjen në procedurë të ri-vlerësimit;**

Kjo ankese është në funksion të respektimit të parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe komplet ne harmoni me dispozitat e LPP-se dhe Rregullores se prokurimit publik.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*

*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*